**Ligji Nr. 03/L - 170**

**PËR MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE**

Kuvendi i Republikës së Kosovës,
Në mbështetje të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,
Miraton

**LIGJ PËR MASAT DOGANORE PËR MBROJTJEN E TË DREJTAVE TË PRONËSISË INTELEKTUALE**

**Neni 1**
Qëllimi1. Ky ligj rregullon procedurat për veprim nga Dogana për mallrat të cilat janë të dyshimta për shkelje të të drejtave të pronësisë intelektuale në situatat kur mallrat janë:
1.1. Të deklaruara për lirim për qarkullim të lirë, eksport ose ri-eksport në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave;
1.2. Gjetur gjatë kontrollit të mallrave duke hyrë ose duke dalë nga territori i Doganave të Republikës së Kosovës, të vendosura nën procedurën e transitit, procedurat e magazinimit Doganor, procedurave të përpunimit te brendshëm, përpunimi nën mbikëqyrjen Doganore, importit të përkohshëm, të vendosur në zonë të lirë, në depo të lirë doganore në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave.
2. Ky ligj po ashtu përcakton masat për mbrojtjen e të drejtave të pronësisë intelektuale që merren nga Dogana kur mallrat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni janë gjetur se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.

**Neni 2**
**Përkufizimet**
1. Për qëllime të këtij ligji, çfarëdo përkufizimi apo rregulle e interpretimit nga neni 4 i Kodit Doganor dhe të Akcizave të Republikës së Kosovës, do të zbatohet edhe në këtë Ligj
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, dhe përveç nëse në bazë të kontekstit parashihet ndryshe për këtë ligj vlejnë përkufizimet si vijon:
2.1. E drejta e pronësisë intelektuale - e drejtë e pronësisë industriale dhe intelektuale e përcaktuara me legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2.2. Mallrat që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale - nënkuptojnë:
2.2.1. Mallrat e falsifikuara:
2.2.1.1. mallrat, duke përfshirë paketimin, mbajtjen pa autorizim të bartësit të së drejtës të markës identike tregtare që është e regjistruar në mënyrë valide përkitazi me të njëjtin lloj të mallrave, apo marke tregtare që nuk mund të dallohen në aspektin thelbësor nga ajo markë tregtare, dhe e cila i shkel të drejtat e bartësit të markës tregtare në bazë të ligjit në fuqi në Kosovë;
2.2.1.2. çdo simbol i markës tregtare (duke përfshire shenjen dalluese, fjalët, shkronjat, figurat, fotot, vizatimet, kombinimet e ngjyrave, format tridimenzionale, format e mallrave dhe paketimet e tyre; kombinimet e simboleve të lartpërmendura, etiketës, afishes, broshurës, udhëzime për përdorim ose dokument që garanton mbajtjen e një simboli të tillë), edhe nëse paraqitet ndarazi nga mallrat, në të njëjtat kushte ashtu sikur mallrat që i referohen pikës së parë si më lartë;
2.2.1.3. paketimi i materialeve që mban markën tregtare të mallrave të falsifikuara, edhe nëse paraqiten ndarazi nga mallrat, nën të njëjtat kushte sikurse mallrat që i referohen pikës së parë si me lartë.
2.2.2. Mallrat e piraterisë - mallra të cilat janë ose përmbajnë kopje të bëra pa miratimin e bartësit të së drejtës së autorit ose të drejtës së ndërlidhur me të, kur bërja e këtyre kopjeve do të paraqiste shkelje të bartësit të së drejtës se autorit ose të drejtës së ndërlidhur me të në bazë të legjislacionit në fuqi në Kosovë;
2.2.3. mallrat që shkelin patentën, dizajnin industrial, të drejtën e emërtimit të prejardhjes ose të drejtën e emërtimit të mbrojtur gjeografik, certifikata për mbrojtje shtesë, e drejta e varitetit të bimës, përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen topografike të qarqeve të integruara në pajtim me Legjislacionin në fuqi në Kosovë.
2.2.4. çfarëdo modeli apo forme, e cila është në mënyrë specifike e dizajnuar apo e përshtatur për prodhimin e mallrave që e shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale po ashtu do të trajtohen si mallra që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, nëse përdorimi i modeleve ose formave të tilla shkel të drejtën e bartësit të së drejtës në Republikën e Kosovës, të tilla si pajisjet, produktet, pjesët përbërëse, kartat smart, dekoderet ose software, swap sisteme ose sisteme për ndryshime tjera.
2.3. Bartësi i së drejtës:
2.3.1. çdo person vendas ose i huaj, Fizik ose Juridik, në pajtim me Ligjin e aplikueshëm në Kosovë, mbajtës i së drejtës së patentës, të drejtës së dizajnit industrial, markës tregtare, certifikata për mbrojtje shtesë, e drejta për varietetin e bimës, emërtimit të mbrojtur të prejardhjes, emërtimit të mbrojtur gjeografik, të drejtës autoriale ose të drejtës së ndërlidhur me të, përcaktimin e te drejtave dhe mbrojtjen topografike të qarqeve të integruara ose
2.3.2. çdo person vendas ose i huaj, Fizik ose Juridik i autorizuar të përdor çdo të drejtë intelektuale të pronësisë të cekur në pikën e parë si me lartë, ose përfaqësues i bartësit të së drejtës ose person i autorizuar që të përdor çdo të drejtë të pronësisë intelektuale.
2.4. Kodi Doganor dhe i Akcizave - Kodin Nr. 03/L-109 te datës 11 nëntor 2008, të Republikës së Kosovës.
2.5. Doganë - Doganat e Republikës së Kosovës përgjegjëse për zbatimin e legjislacionit doganore.
2.6. Ministri – Ministrin e Ministrisë për Ekonomi dhe Financa.

**Neni 3**
**Kërkesa për veprim nga Dogana Masat paraprake për kërkesën për veprim nga Dogana (procedura sipas detyrës zyrtare)**
1. Dogana, në kursin e veprimit në një nga situatat që i referohen paragrafit 1 të nenit 1, të këtij Ligji dhe para se kërkesa është parashtruar nga bartësi i së drejtës, kanë baza të mjaftueshme për të dyshuar se mallrat shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, atëherë mund të anulojë lirimin e mallrave ose t'i ndalojnë ato.
2. Dogana njofton bartësin e së drejtës për masat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni në mënyrë që ti mundësojë bartësit të së drejtës të dorëzoj një kërkesë për veprimin në pajtim me nenin 4 të këtij Ligji. Deklaruesi ose pronari i mallrave, do të njoftohen po ashtu.

3. Dogana mund po ashtu, pa publikuar asnjë të dhënë përveç sasisë aktuale apo të supozuar të mallrave dhe natyrës e tyre dhe para se të informohet bartësi i së drejtës për ndonjë shkelje të mundshme, të pyes bartësin e së drejtës që t'i pajis me çfarëdo të dhënë që do të ju nevojitet për të konfirmuar dyshimet e tyre.
4. Brenda tre (3) ditëve të punës pas njoftimit, nëse bartësi i së drejtës nuk parashtron kërkesën për veprimin në pajtim me nenin 4 të këtij Ligji, lejohet lirimi i mallrave apo ndërpritet periudha e ndalesës, me kusht që të gjitha procedurat Doganore janë plotësuar.

**Neni 4**
**Parashtrimi dhe procedimi i Kërkesës për Veprim nga Dogana**
1. Bartësi i së drejtës mund të kërkoj me shkrim tek Dogana për veprim kur mallrat janë gjetur në njërën nga situatat që i referohen paragrafit 1 të nenit 1 të këtij Ligji.
2. Kërkesa për veprim bëhet në një formular, të përcaktuar nga Drejtori Gjeneral i Doganës. Kërkesa përmban të gjitha të dhënat e nevojshme për të mundësuar që mallrat në fjalë të njihen lehtësisht nga Dogana, dhe në veçanti përmbajnë:
2.1. Përshkrimin teknik të detajuar dhe të saktë të mallrave;
2.2. Çdo të dhënë të veçantë që bartësi i së drejtës ka lidhur me llojin e shkeljes;
2.3. Emrin, mbiemrin dhe detajet e kontaktit të personit kontaktues të caktuar nga bartësi i së drejtës.
3. Kërkesa për veprim do të parashtrohet së bashku me deklaratën e përgjegjësisë nga parashtruesi i kërkesës sipas neni 5 të këtij Ligji dhe dëshminë që parashtruesi i kërkesës mban të drejtat për mallrat në fjalë.
4. Bartësi i së drejtës po ashtu mundet të përcjell çdo të dhënë që ai mund të ketë në lidhje me:
4.1. Vlerën doganore të mallrave origjinale në Republikën e Kosovës;
4.2. Lokacionin e mallrave ose destinacionin e paraparë të tyre;
4.3. Detajet që identifikojnë ngarkesën (dërgesën);
4.4. Arritjen e planifikuar ose datën e nisjes së mallrave;
4.5. Detajet e mjeteve të përdorura për transport;
4.6. Detajet e identitetit të importuesit, eksportuesit ose të bartësit të mallrave;
4.7. Vendi i prodhimit dhe rrugët qe përdoren për transport;
4.8. Ndryshimet teknike, nëse dihen, në mes të mallrave origjinale dhe mallrave që dyshohen se shkelin të drejtat e pronësisë intelektuale.
5. Përveç të dhënave që i referohen paragrafëve 2, 3 dhe 4 të këtij neni, po ashtu mund të kërkohen detaje që janë specifike për llojin e të drejtës së pronësisë intelektuale.
6. Me pranimin e kërkesës për veprim, Dogana do të procedoj ketë kërkesë dhe të njoftojë me shkrim parashtruesin e kërkesës për vendimin brenda tridhjetë (30) ditëve të punës pas pranimit të kërkesës për veprim.
7. Dogana do të ngarkoj me taksë parashtruesin e kërkesës për të mbuluar shpenzimet me rastin e procedimit të kërkesës. Shuma e taksës për parashtruesin e kërkesës do të përcaktohet nga Ministri me akt nënligjor.
8. Nëse kërkesa për veprim nuk përmban informatat detyruese të parapara sipas këtij neni ose nëse të dhënat nuk janë të mjaftueshme, Dogana refuzon kërkesën për veprim dhe në këtë rast duhet të jap arsye me shkrim për këtë. Një kundërshtim i veçantë kundër një vendimi të tillë mund të paraqitet tek Dogana brenda periudhës tridhjetë (30) ditësh nga data e pranimit së këtij vendimi.

**Neni 5**
**Deklarata e Përgjegjësisë**
1. Me deklarimin që i referohet paragrafit 3 të nenit 4 të këtij Ligji, bartësi i së drejtës duhet të marrë përsipër përgjegjësinë ndaj personave të përfshirë në njërën nga situatat që i referohen paragrafit 1 të nenit 1 të këtij Ligji, në rast kur:
1.1. procedura e iniciuar në pajtim me paragrafin 1 të nenit 8 të këtij Ligji nuk është vazhduar për shkak të një veprimi apo dështimi nga bartësi i së drejtës,
1.2. për mallrat në fjalë janë konstatuar se nuk e shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale.
2. Me një deklaratë të tillë, bartësi i së drejtës gjithashtu pajtohet që të mbart të gjitha harxhimet të shkaktuara nga mbajtja e mallrave nën mbikëqyrjen e Doganës në pajtim me këtë Ligj.

**Neni 6**
Dispozitat e nenit 4 dhe 5 të këtij Ligji parashtrojnë kërkesën përshtatshmërisht për të kërkuar vazhdimin e periudhës së referuar në nenit 7 të këtij Ligji.

**Neni 7**
**Pranimi i kërkesës për veprim**
1. Kur plotësohet kërkesa për veprim të përcaktuar në nenin 4 të këtij Ligji, Dogana do të specifikoj periudhën gjatë së cilës veprimi duhet të ndërmerret. Kjo periudhe nuk do të kaloj 1 vit nga data e pranimit të kërkesës për veprim. Së paku pesëmbëdhjetë (15) ditë para skadimit të periudhës në fjalë, dhe paraprakisht duke ju nënshtruar shlyerjes së çfarëdo lloj borxhi të krijuar nga bartësi i së drejtës sipas këtij ligji, bartësi i së drejtës mund të kërkojë për zgjatje të periudhës.
2. Dogana vendimin për aprovimin e kërkesës për veprim dhe vendimin për vazhdimin e periudhës e dërgon menjëherë të gjitha zyrat doganore për veprim.
3. Bartësi i së drejtës në afat prej pesë (5) ditëve të punës njofton Doganën për skadimin e vlefshmërisë të së drejtës se tij.
4. Nëse bartësi i së drejtës nuk e njofton Doganën sipas paragrafit 3 të këtij neni, aplikohet neni 18 i këtij Ligji.
5. Sipas kërkesës së Doganës, parashtruesi i kërkesës siguron çdo të dhënë shtesë të nevojshme për zbatimin e vendimit për aprovimin e kërkesës.

**Neni 8**
**Kushtet që përcaktojnë veprimin nga Dogana**
1. Nëse zyra doganore, së cilës i është përcjell vendimi aprovues i kërkesës për veprim, konsideron se mallrat në njërën nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 1 i këtij Ligji janë të dyshimta për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale të mbuluar nga

ky vendim, do të anuloj lirimin e mallrave ose të ndalojë ato nën mbikëqyrje Doganore. Zyra Doganore informon zyrën qendrore të Doganës.
2. Dogana do të informojë bartësin e së drejtës, deklaruesin, pronarin e mallrave për veprimet e saj dhe është e autorizuar ti informojë ata për sasinë aktuale ose të vlerësuar dhe natyrën aktuale ose të supozuar të mallrave, lirimi i të cilave është pezulluar ose të cilat janë ndalur dhe për mundësinë e aplikimit të procedurës së thjeshtësuar sipas nenit 9 të këtij Ligji.
3. Me qëllim të përcaktimit se nëse e drejta e pronësisë intelektuale është shkelur sipas Ligjit, dhe në pajtim me dispozitat e ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale, sekretit komercial dhe industrial, Dogana mund të informojë bartësin e se drejtës, sipas kërkesës së tij, për emrat dhe adresat e marrësit dhe dërguesit, deklaruesit ose pronarit të mallrave, origjina dhe prejardhja e mallrave të dyshuara për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale, nëse dihen.
4. Sipas kërkesës së bartësit të së drejtës dhe personave të përfshirë në çfarëdo situate te përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni, Dogana do t'u japë atyre mundësinë të inspektojnë mallrat lirimi i të cilave është pezulluar apo ndaluar. Dogana mund të marr mostra në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave, dhe mund të lejoj bartësin e të drejtës ti inspektoj ato. Dogana mund po ashtu ti dërgoj mostrat te bartësi i së drejtës në bazë të kërkesës se tij me shkrim dhe vetëm për qëllime të analizës dhe të lehtësimit të procedurave që vijojnë. Mostrat duhet të kthehen pas kompletimit të analizës teknike, në rastet ku janë të zbatueshme, dhe para se mallrat të lirohen apo ndalesa e tyre të ndërpritet.

**Neni 9**
1. Në rastet kur Dogana e ndalon ose e anulon lirimin e mallrave të cilat janë të dyshimta për shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale në njërën nga situatat e përcaktuara në paragrafin 1 të nenit 1 të këtij Ligji, të braktisura për shkatërrim, Dogana mund të autorizoj procedurë të thjeshtësuar, për tu përdorur me marrëveshjen e bartësit të së drejtës, e cila i mundëson Doganës për të shkatërruar mallra të tilla nën mbikëqyrje Doganore, pa pasur nevojë të përcaktoj nëse e drejta e pronësisë intelektuale është shkelur sipas Ligjit, me kusht qe:
1.1. Bartësi i së drejtës informon me shkrim Doganën brenda tetë (8) ditëve të punës ose tre (3) ditëve të punës në rastet kur mallrat janë të natyrës që prishen shpejt, pas njoftimit të dhënë sipas nenit 8 të këtij Ligji, se mallrat në bazë të procedurës shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale dhe i ofron Doganës marrëveshjen me shkrim të deklaruesit, bartësit ose pronarit të mallrave për të hequr dorë, me qëllim të shkatërrimit të mallrave, dhe
1.2. Shkatërrimi kryhet me shpenzimet dhe nën përgjegjësinë e bartësit të së drejtës në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave për shkatërrim të mallrave nën mbikëqyrje të Doganës, paraprakisht duke marrë mostra për të pasur fakte të pranueshme në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave.
2. Duke iu referuar nën-paragrafit 1.1 të këtij neni, deklaruesi, bartësi ose pronari i mallrave mund të ofroj në mënyrë të drejtpërdrejt marrëveshjen për heqjen dorë nga mallrat për qëllime të shkatërrimit të tyre nga Dogana. Duhet të konsiderohet se deklaruesi, bartësi ose pronari i mallrave ka ofruar marrëveshjen për shkatërrim nëse ai në mënyrë specifike nuk e ka kundërshtuar këtë, për të cilin ka qenë i informuar me herët brenda periudhës së përcaktuar. Kjo periudhë mund të vazhdohet për dhjetë (10) ditë pune të tjera në raste të caktuara duke përjashtuar rastet kur mallrat janë të natyrës që prishen shpejt.
3. Dogana nuk do të jetë përgjegjëse për dëmtimet që mund të ndodhin gjatë shkatërrimit të mallrave në pajtim me këtë nen.
4. Në çdo rast tjetër, ku kushtet e caktuara në paragrafin 2 të këtij neni nuk janë të harmonizuara, atëherë procedura e përcaktuar në nenin 11 të këtij Ligji duhet të zbatohet.

**Neni 10**
1. Bartësi i së drejtës duhet të përdor të dhënat e cekura në paragrafin 3 të nenit 8 të këtij Ligji për procedurën e përcaktimit se nëse është shkelur e drejta e pronësisë intelektuale, po ashtu edhe për qëllimet e caktuara në nenin 9 dhe paragrafin 1 të nenit 11 të këtij Ligji.
2. Në rastin kur të dhënat janë përdorur në kundërshtim me paragrafin 1 të këtij neni, Dogana do të anuloj vendimin për të pranuar kërkesën për veprim për periudhën e mbetur. Nëse bartësi i së drejtës nuk vepron sipas këtij neni, aplikohet neni 19 i këtij Ligji.3. Në rast të shkeljes se mëtutjeshme apo shkeljes me të rënde të dispozitave të paragrafit 1 të këtij neni, Dogana mund të refuzojë vazhdimin e periudhës, të përcaktuar në nenin 7 të këtij Ligji.
**Neni 11**
1. Nëse, brenda dhjetë (10) ditëve të punës pas njoftimit për pezullimin, lirimin apo ndaljes, Dogana nuk ka pranuar deklaratën me shkrim nga bartësi i së drejtës sipas nenit 12 dhe 13 të këtij Ligji, apo nëse nuk ka pranuar marrëveshjen e bartësit të së drejtës të përcaktuar në paragrafin 1 të nenit 9 të këtij Ligji, Dogana do të liroj mallrat me kusht që të gjitha procedurat doganore të jenë përmbushur. Kjo periudhë mund të zgjatet në maksimum dhjetë (10) ditë tjera pune, në rastet e caktuara.
2. Në rast së mallrat, që janë të natyrës që prishen shpejt, dyshohen se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, periudha e referuar në paragrafin 1 të këtij neni do të jetë tre (3) ditë pune dhe nuk mund të vazhdohet.

**Neni 12**
1. Bartësi i së drejtës duhet të njoftojë Doganën brenda dhjetë (10) ditëve të punës së procedura për përcaktimin e shkeljes së të drejtës së pronësisë intelektuale është iniciuar:
1.1. Me parashtrimin e kërkesës gjykatës kompetente për caktimin e masave të përkohshme, ose
1.2. Me parashtrimin e padisë gjykatës kompetente.
2. Me nisjen e procedurës së përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni periudha e pezullimit të lirimit të mallrave ose ndaljes zgjatet deri sa gjykata të nxjerr vendim në lidhje me këto mallra.

**Neni 13**
1. Në rast kur mallrat dyshohet se shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, pronari, bartësi, importuesi ose dërguesi i mallrave mund të jetë në gjendje të sigurojnë lirimin e mallrave nën dispozitën e ruajtjes, me kusht që:
1.1. Dogana është njoftuar, në pajtim me paragrafin 1 të nenit 11 të këtij Ligji, që procedura është iniciuar për të provuar nëse e drejta e pronësisë intelektuale është shkelur sipas Ligjit;

1.2. Gjykata Kompetente për këtë qëllim nuk ka autorizuar masat për konfiskimin e mallrave para se të skadojë periudha e paraparë në paragrafin 1 të nenit 11 të këtij Ligji dhe
1.3. Të gjitha procedurat Doganore janë përfunduar.
2. Siguria e dhënë në paragrafin 1 të këtij neni duhet të jetë e mjaftueshme të mbroj interesat e bartësit të së drejtës. Pagesa e ruajtjes nuk duhet të ndikojë në kompensimet e tjera ligjore të disponueshme ndaj bartësit të së drejtës.
3. Lloji, procedura, mënyra e pajisjes me garantues, mbledhja dhe lirimi duhet të rregullohen nga Ministri me akt nënligjor.

**Neni 14**
1. Magazinimi i mallrave gjatë periudhës së anulimit të lirimit ose ndaljes zhvillohen në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe Akcizave që parashohin magazinimin e përkohshëm të mallrave.
2. Shpenzimet për magazinimin dhe mirëmbajtjen e mallrave i mbart personi që e parashtron kërkesën për veprim.

**Neni 15**
**Mallrat e gjetura të cilat shkelin të Drejtën e Pronësisë Intelektuale**
1. Mallrat e gjetur të cilat shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale në përfundim të procedurës, të përcaktuar nga neni 8 i këtij Ligji, nuk do të:
1.1. lejohen të hyjnë në territorin Doganor të Republikës së Kosovës;
1.2. të lirohen për qarkullim të lirë;
1.3. të largohen nga territori Doganor i Republikës së Kosovës;
1.4. të eksportohen;
1.5. të ri-eksportohen;
1.6. të vendosen nën procedurë pezulluese; ose
1.7. të vendosen në zonë të lirë ose depo të lirë.2. Nëse bartësi i së drejtës vepron në kundërshtim me këtë nen, aplikohet dispozita e nenit 20 të këtij Ligji.

**Neni 16**
1. Nëse gjatë procedimit para autoritetit kompetent vendimi është miratuar për të shkatërruar ose sistemuar jashtë kanaleve komerciale mallrat që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale, Dogana urdhëron që:1.1. Mallrat nën mbikëqyrje Doganore duhet të shkatërrohen ose përndryshe të sistemohen jashtë kanaleve komerciale, në këtë mënyrë që të parandaloj dëmtimin e bartësit të së drejtës, pa asnjë lloj kompensimi dhe shpenzimi për Doganën.
1.2. Të merren masa tjera (përfshirë braktisjen e mallrave për qëllime humanitare) që në mënyrë efikase të pengoj personat e interesuar që kanë tendencë për ndonjë përfitim ekonomik nga transaksioni. Thjeshtë, heqja e markës tregtare e cila ka qenë e vendosur në mallrat e falsifikuara pa autorizim, nuk duhet të konsiderohet si mënyrë efikase për pengimin e personave të interesuar për ndonjë përfitim ekonomik nga transaksioni.

**Neni 17**
**Përgjegjësia e Doganës dhe e Bartësit të së Drejtës**
1. Pranimi i një kërkese nuk do t'i jap të drejtë për kompensim bartësit të së drejtës në rast se mallrat që shkelin të drejtën e pronësisë intelektuale nuk janë zbuluar nga Dogana dhe janë liruar ose nuk është marrë ndonjë veprim për t'i ndaluar ato sipas paragrafit 1 të nenit 8 të këtij Ligji.
2. Zbatimi i kompetencave dhe veprimeve të marra nga Dogana në pajtim me këtë Ligj nuk nënkupton se ajo është e detyruar të bëjë kompensim ndaj personave të përfshirë në situatat e referuara në paragrafin 1 të nenit 1 të këtij Ligji.

**Neni 18**
**Dispozitat Kundërvajtëse**
1. Për kundërvajtje gjoba në shumën prej 2.000 Euro do të caktohet kundër personit juridik për shkelje, nëse vepron në kundërshtim me paragrafin 2 të nenit 7 të këtij Ligji, nëse nuk e njofton Doganën për skadimin e të drejtës së tij brenda pesë (5) ditëve të punës.
2. Për kundërvajtje gjoba në shumë prej 500 Euro caktohet kundër personit fizik për veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

**Neni 19**
1. Për kundërvajtje gjoba në shumë prej 2.000 Euro do të caktohet kundër personit juridik, i cili vepron në kundërshtim me paragrafin 1 të nenit 10 të këtij Ligji, përdor informacionin e dhënë nga Dogana në kuptim të nenit 9 dhe paragrafit 1 të nenit 11 të këtij Ligji jashtë procedurave dhe qëllimeve të përcaktimit të shkeljes së pronësisë intelektuale.
2. Për kundërvajtje gjoba në shumë prej 500 Euro caktohet kundër personit fizik për veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

**Neni 20**
1. Për kundërvajtje gjoba në shumë prej 2.000 deri 5.000 Euro do të caktohet kundër personit juridik që vepron në kundërshtim me nenin 15 të këtij Ligji, për paraqitje, lirim për qarkullim të lirë, dalje, eksportim, vendosje nën procedurë të anulimit ose hyrje në zonë të lirë ose depo të lirë të mallrave për të cilat, në procedurën e mëparshme të kompletuar në pajtim me nenin 8 të këtij Ligji, është përcaktuar së shkakton shkelje të së drejtës së pronësisë intelektuale.
2. Për kundërvajtje gjoba në shumë prej 200 deri 400 Euro, do të caktohet kundër personit fizik për veprimet e përcaktuara në paragrafin 1 të këtij neni.

**Neni 21**
**Dispozitat Përfundimtare dhe Përjashtimet**
1. Ky ligj nuk aplikohet në:

1.1. Mallrat që mbajnë markën tregtare me miratimin e bartësit të markës tregtare ose të mallrave që mbajnë emërtimin të mbrojtur të prejardhjes ose emërtim të mbrojtur gjeografik apo ato të cilat janë të mbrojtura me patentë, certifikata për mbrojtje shtesë, e drejta e varitetit të bimës, nga e drejta e autorit ose e drejtë e ndërlidhur me të ose nga një e drejtë e dizajnit industrial, për përcaktimin e të drejtave dhe mbrojtjen e topografive të qarqeve të integruara dhe të cilat janë prodhuar me miratimin e bartësit të së drejtës, në rastin kur ato janë të vendosura në njërën nga situatat që i referohen paragrafit 1 të nenit 1 të këtij Ligji pa miratimin e bartësit të së drejtës sipas licencës.
1.2. Mallrat që i referohen paragrafit 1 të këtij neni të cilat janë prodhuar nën kushte tjera përveç atyre me të cilat është pajtuar bartësi i së drejtës.
1.3. Mallrat pjesë e bagazhit personal të udhëtarit, gjëra të natyrës jo komerciale të vlerës minimale të hyra se bashku me gjërat nga bagazhi personal i udhëtarit dhe gjërat të natyrës jo komerciale të vlerës minimale të pranuara nga jashtë, kohë pas kohe dhe të liruara nga pagesa e importit në pajtim me dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave, me kusht që nuk ka baza të arsyeshme për të dyshuar se mallrat janë pjesë e trafikut komercial.

**Neni 22**
**Dispozitat Kalimtare**
1. Po qe se nuk është paraparë ndryshe me këtë Ligj, Dogana që zbaton procedurën duhet të aplikoj dispozitat e Kodit Doganor dhe të Akcizave. Dispozitat e Ligjit mbi Procedurën e Përgjithshme Administrative aplikohen si përjashtim.
2. Dispozitat e këtij Ligji nuk do të bien ndesh me ligjet e aplikueshme në Kosovë që rregullojë mbrojtjen e të drejtës së pronësisë industriale dhe intelektuale.

**Neni 23**
Aktet NënligjoreMinistri në afat prej 6 (gjashtë) muajve nga dita e hyrjes në fuqi të këtij ligji nxjerr aktet nënligjore për zbatimin e këtij ligji.

**Neni 24**
Neni 9 i këtij Ligji fillon të zbatohet 6 (gjashtë) muaj pas hyrjes në fuqi të këtij Ligji.

**Neni 25**
ShfuqizimetMe hyrjen në fuqi të këtij Ligji shfuqizohet Rregullorja e UNMIK-ut 2008/22 e datës 6 maj 2008 dhe të gjitha dispozitat tjera që janë në kundërshtim me këtë Ligj.

**Neni 26**
Hyrja ne fuqiKy ligj hyn në fuqi 15 ditë pas publikimit të tij në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 03/L – 170**
**29 dhjetor 2009**

**Shpallur me dekretin Nr. DL-004-2010,**
**datë 08.01.2010 nga**

**Presidenti i Republikës së Kosovës,**
**Dr. Fatmir Sejdiu.**